



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 621/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi -Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatoreve ekonomik: “Mirusha Company” Sh.p.k. & “Lika Trade” Sh.p.k. & “Infra-Plus” Sh.p.k. – Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Transiti i ri”, me numër të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna e Gjakovës, më datën 16.10.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Transiti i ri”, me numër të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna e Gjakovës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Transiti i ri”, me numër të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna e Gjakovës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 10.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 24.06.2019

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 27.05.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 27.05.2019

Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt: 16.09.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 23.06.2019

Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë: 08.07.2019.

Operatori ekonomik ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën: 20.09.2019 me nr. 621/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Transiti i ri”, me numër të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 51, 56, 67, 59, 68, 69, 70, dhe 71, të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 2, 26, 27, dhe 41, të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 23.09.2019, ka autorizuar ekspertin e jashtëm teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti i jashtëm teknik në raportin e dt: 09.10.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin nr. 1 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues, se OE “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K i rekomanduar për kontratë, në bazë të Njoftimi mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues të datës 16.09.2019, kurse me vendimin e datës 24.06.2019 të Autoritetit Kontraktues është shpallur tenderues i pasuksesshme dhe tenderi i tyre është refuzuar: Duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim në Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit përkatësisht seksioni II të FTD të; Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2; Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkohej: Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.; Dëshmia e kërkuar dokumentare Produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN (Produktet e ndriçimit publik dhe sinjalizimit janë të specifikuara në pozicionet e paramasës së projektit), - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar me rastin e dorëzimit të ofertës grupi i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar: Certifikatën për Standardin EN 12352:2006, EN 62031, EN 61347-1, EN 61347-2-13, EN 62031, EN 62471 (për ndriçimin publik në ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Referohuni në specifikimin teknik paramasa), në pikën 3 dhe 4 ku kërkohej që: Raportet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (të dorëzohen me ofertë) – EN 60598-1 (2015), EN 12352:2006, EN 61000 – 3-2, EN 62031, EN 61347-1, EN 61347-2-13 EN 61547, EN 62031, EN 55015, EN 62471.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatori ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues, se OE i rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & „LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, Në katalogun e ofruar për trupat ndriçues të kompanisë SUNBRIGHT SYSTEM BULGARIA Ltd, asnjë trup ndriçues nuk është 80W dhe 150W, gjithashtu asnjë karakteristik nuk është siç është kërkuar në FDT. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar si dëshmi katalogun për trupat ndriçues të kompanisë SUNBRIGHT SYSTEM BULGARIA Ltd në të cilin nuk janë dhënë karakteristikat për trupat ndriçues 80W dhe 150W prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 3 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues, se OE i rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & „LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K nuk ka ofruar dëshmi për Certifikatën e ngjyrës sipas UNE- EN 1436: 2009, sipas kërkesës së dosjes së tenderit respektivisht në FDT eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar si dëshmi CERTIFIKATËN numër : SKO5-ZSV -0220 të lëshuar nga një organ i pavarur i akredituar i certifikimit i Shteteve Anëtare të BE-së që produkti Ngjyra e bardhë SIGNOCRYL për shenjat përputhet me kërkesat e standardeve të Bashkimit Evropian EN 1436 në lidhje me standardin EN të harmonizuar të Republikës së Sllovenisë prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues, se OE i rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K nuk ka dorëzuar paramanën në formatin Exel, Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar paramasen sipas udhëzimeve të Manuelit për OE – Përgatitja dhe dorëzimi i Ofertës , E – Prokurimi, Plotësimi i çmimeve – Lista e Çmimeve Jo e standardizuar Nëse Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur Listën e Çmimeve Jo të Standardizuar, atëherë Lista e Çmimeve pjesë e Dosjes së Tenderit duhet të ngarkohet si dokument. Lista e Çmimeve mund të jetë në forma të ndryshme (Word, Excel, PDF). prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 5 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues, se AK: Komuna e Gjakovës se ka bërë shkelje të ligjit gjatë fazës së Ri- vlerësimit. Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve të pranuar sqaron se: Kërkesa për vazhdimin e validitetit të tenderit nga OE është bërë me datën 10.09.2019.

- Kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit si: Vërtetim i Administratës Tatimore, Vërtetim i Gjykatës dhe Vërtetimi i tatimit në pronë nga Ak-ja me datën 10.09.2019
- Vazhdimi i validitetit të ofertës nga OE është bërë me datën 12.09.2019
- Data e nënshkrimit të raportit të vlerësimit nga Komisioni për vlerësim dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit është 13.09.2019
- Publikimi i B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues është bërë me datë:13.09.2019 si dhe B42 Letrat standarde për tenderuesit e eliminuar, të pa suksesshëm dhe të suksesshëm, Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton AK i ka udhëheq procedurat sipas ligjit dhe se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 6 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & Lika Trade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K nuk ka dorëzuar Sigurimin e tenderit në emër

te konzorciumit por vetëm në emër të dy operatorëve ekonomik "LikaTrade" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K, ndërsa operatori tjetër "Infra - Plus" SH.P.K nuk është. Në Sigurimin e tenderit nuk është "Mirusha Company" SH.P.K e para pasi që është edhe lideri i konzorciumit. . Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve të pranuara sqaron se: sipas Ligjit Nr. 04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, Neni 57 – Sigurimi i tenderit paragrafi 1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender pra nuk përcaktohet se cili nga anëtarët e grupit duhet të bëjë sigurimin e tenderit Prandaj bazuar në dëshmitë e lart përmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr .7 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & Lika-Trade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se partnerit te konzorciumit "Infra -Plus" SH.P.K i mungon deklarata për specifikime teknike si dhe Aneksi i specifikacionet teknike te detyrueshme nuk janë te nënshkruara dhe të vulosura nga të gjithë anëtarët e konzorciumit. Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve të pranuara sqaron se Deklarata e Specifikimeve teknike të detyrueshme është e nënshkruar nga anëtarë i grupit Lika-Trade dt: 27.05.2019 kurse nga anëtarët e tjerë nuk është e nënshkruar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 8 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se partnerit te konzorciumit "Infra -Plus" SH.P.K i mungon Deklaratat tatimore vjetore për 3 vitet e fundit te kërkuara sipas FDT. Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve te pranuara sqaron se anëtarët e grupit "Mirusha Company" Sh.p.k& Lika-Trade" i kanë te bashkangjitura Deklaratat tatimore për tri vitet e fundit kurse Infra-Plus SH.P.K nuk e ka dorëzuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 9 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & Lika-Trade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se diploma e inxhinierit z.Besmir Veselaj, inxhinier Gjeodet, diploma e tij është e noterizuar me datën 01.08.2016 gjë që është noterizim 3 vite më i vjetër Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve te pranuara sqaron se Dokumenti është valid sepse noterizimi i këtij dokumenti është bërë nga origjinali dhe në bazë të ligjit nr. 06/L-010 Për Noterinë, nuk është përcaktuar vlefshmëria e dokumentit te noterizuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 10 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se kontrata e punës e inxhinierit te elektroteknikes Sami Shatri është nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019 e cila nuk është kontrate pune deri ne fund te projektit. Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve te pranuar sqaron se kontrata e inxhinierit te elektroteknikes z.Sami Shatri është valide sepse me rastin e dorëzimit te ofertave numri i ditëve te përfundimit te kontratës se inxhinierit te Elektroteknikes është me i madhe se sa numri i ditëve te planit dinamik (179 ditë) për kryerjen e punimeve i dorëzuar me rastin e dorëzimit te ofertës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 11 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 Operatori Ekonomik "Lika-Trade " SH.P.K, listën e pajisjeve te paraqitur nuk e ka sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Ekskavatorët me peshe minimale 13 t, ka paraqitur katër (4) ekskavator, te cilët nuk i ka me peshën e kërkuar Është me minus një kamion sepse njeri kamion me targat: 03-921-DB i ka skaduar regjistrimi me 03.05.2019. Eksperti shqyrtues ne baze te fakteve te pranuar sqaron se këto mjete ne baze te listave te pajisjeve te dorëzuara nga anëtarët e grupit i plotëson kërkesën sipas listës se pajisjeve pika 1 Ekskavatorët me peshe totale minimumi 13 t dhe atë ne baze te Kontratës mbi shit blerjen e makinerive te renda dt: 08.08.2012 e mes te Construcsioni Gienerali Italia L.L.C. dhe Mirusha Company.

- EskoatorPC 210 viti 2003 Pesha 16300kg
- Eskovator KOMATSU tipi PC 160 LC -7K viti 2003 Pesha 16300kg
- EskavatorO&K tipi RH6-22 1999 pesha 22000kg

Në bazë të faturës 13/15 dt 01.12.2015

- Eskavator PC340 viti 2000 Pesha 24600kg

Pesha e tyre është konstatuar në bazë te Dudit Doganor apo te katalogut te tyre ne faqe te internetit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr.12 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & „LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K Është me minus një kamion sepse njeri kamion me targat: 03-921-DB i ka skaduar regjistrimi me 03.05.2019 Një herit numrin i kamionëve te cilët janë ne listat e pajisjeve qe i kanë ne posedim te dy anëtarët e te grupit "Mirusha Company" Sh.p.k; dhe "LikaTrade " SH.P.K është njëmbëdhjetë Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr.13 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & „LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K se Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 Operatori Ekonomik "LikaTrade " SH.P.K, listën e pajisjeve te paraqitur nuk e ka sipas kërkesës se dosjes se tenderit te lista e pajisje nr. 5 I mungon e një cilindër me peshe totale minimumi 4t deri 12 t. Eksperti shqyrtues në bazë të fakteve te pranuar sqaron se këto mjete ne baze te listave te pajisjeve te dorëzuara nga anëtarët e grupit i plotësojnë kërkesën sipas listës se pajisjeve te kërkuar te pika 5 . Cilindër apo rula ngjeshës me peshe totale minimum 4t deri ne 12 t dhe atë.

- Marka HAMM HW90B/12 nr. serik: 2333637 viti 1992 Referenca doganore R 21557 "LikaTrade"
- Cilindër i përdorur marka : HAMM tipi : DV6K nr. serik 45808 viti 2001 pesha : 7500 kg Referenca doganore R 21549 dt. 18.07.2013 "LikaTrade"
- Makina ngjeshës Rulet tipi HD 75 K, pesha: 9790 kg, viti 2004 nr serik H1520665 numri i faturës 01/2019 dt. 21/02/2019 "Mirusha Company" Sh.p.k;

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr.14 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & „LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K Sipas dosjes se tenderit për Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 tek pjesa e autorizimeve për sinjalizim horizontal dhe vertikal nuk janë te paraqitura EN standardet sipas FDT, dhe ka te prezantuar vetëm një pjese te katalogut 3M, gjithashtu ka te prezantuar vetëm një pjese te katalogut Trafic Yet, dhe një certifikate për printim te produkteve. Eksperti shqyrtues ne baze te fakteve te pranuar sqaron Gjate shqyrtimit te dokumentacionit te ofruar me rastin e dorëzimit te ofertës grupi i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar Certifikata UNE-EN 1436:2009 +A1 2009- Sinnjalizimi Horizontal si dhe Diamond Grade EN 12899 Min. 27 luminance KR 580-420-120 Cd/Lux/m2 1-7 vite 80% 8-11 vite 70%, katalogët e dorëzuar nuk i përshkruajnë te gjitha elementet e sinjalizimit siç janë kërkuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar

Te gjitha pretendimet e OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues për OE SH." Drini Company" i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm e janë te shqyrtuara me pare me Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 400-419 te datës 13.08.2019 me dhe për te cilat është marre vendim nga OSHP-ja 400-419 te datës 06.09.2019

Lidhur me pretendimin nr. 15 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Ne mbështetjen e tij bankare siç është kërkuar ne dosjen e tenderit nuk e ka te sakte emërtimin e projektit si ne dosjen “ Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores- Transiti i ri (ne gjuhen angleze: Re Tender Construction of Circular - New tranzit) por e ka me titull te projektit te mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Transiti i Ri (ne gjuhen angleze si e ka ne Mbështetje Bankare: Construction of Qarkores – Transiti i ri) gjë e cila po bije ne kundërshtim me dosjen e tenderit te publikuar nga Autoriteti Kontraktues . Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit sepse Autoriteti Kontraktues ka ber vlerësim te drejte sepse Operatori ekonomik ne mbështetjen bankare te dorëzua i ka te shënuara te dy numrat atë te prokurimit dhe atë të numrit te brendshëm sipas Dosjes se shpallur kurse emri mendoj se është një shkelje e vogël e cila nuk duhej te merret si shkelje. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pa bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 15 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Tek pjesa e kontratave për punë të ngjashme kemi vërejtur se kontrata e OE: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës se Kosovës 2015-2016, kjo kontratë nuk figuron si kontrata të tjera por që vërejmë se Kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 është përsëritur dy herë në mënyrën e njëjtë kurse kontrata Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale së Republikës së Kosovës 2015-2016 nuk figuron në dosjen e tij për punë të ngjashme dhe as nuk është pranimit teknik, veçmas një referencë e lëshuar në 03.11.2017, por që kjo kontratë nuk duhet të pranohet as si kontrata e valide e as si referencë pasi që është e vitit 2014/2015 dhe që në dosje të tenderit kontratat për punë të ngjashme duhet me qenë të tri{3} viteve të fundit. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se operatori ekonomik te njëjtën kontrate (Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës se Kosovës 2015-2016) ne regjistrin e kontratave e ka përsëritur dy here kurse ne llogari është llogaritur vetëm një here Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 16 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Tek lista e kontratave gjithashtu ka paraqitur kontratën Rikonstruktimi i Rrugës Kukës – Shishtavec, Lot 2 me vlerë 4,126,156.78€, në të cilin projekt Sh. Drini Company SH.P.K nuk

është lideri por vetëm si partner i dytë me 40% i tij i cili i bije të ketë vlerën 1,600,000.00€. Nga kjo rezultojnë se Operatori Ekonomik nuk e përmbush kërkesën sipas dosjes së tenderit ku kërkohen që Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3{tri} vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratën. Në një vlerë se jo më pak se 5.000.000.00€ gjë që Operatori Ekonomik Sh. Drini Company nuk e përmbush këtë kriter dhe vlera e kontratave për punë të ngjashme mbërrin: 4,615,203.3€. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në baze të kontratës dhe formularit të vlerësimit Nga : Fondi Shqiptar i Zhvillimit tek % e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punimeve të kryera nga secili anëtarë është se NNTTSH “DRINI COMPANY” SHPK -40% të punimeve i ka kryer dhe shuma e punimeve të kryera sipas kësaj kontrate është $= 543,105,378.25 \text{ lek} \times 0.4 = 217,242,151.30 / 132.59 = 1,638,450.49 \text{ euro}$. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar

		Kontrata	Vlera e kontratës	Kontrata të komitizimit	ta nënshkruar	imi verbal/ pranimit teknik	Vërejtje
1	623 -14 -018 - 521	Asfaltimi i rrugës Pastasel – Koznik KK Rahovec.	20,640.00	/	Aneks Po 04.07.2016	Po nr.8491 19.07.2016	E vlefshme
2	Mi/ 14/051 /211	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2014/2015 R. Prizreni 2	763,535.39	173.37	Po 14.11.2014	Po 07.11.2017	Është e dhënë në dy kopje
3	/	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2015/2016 R. Prizreni 2	496,668.06	173.37	Jo	Po nr.8491 07.11.2017	Shënimet janë marrë në baze të referencës nr.8491 dt. 07.11.2017
4	Mi/205/17/ 5353/215	Mirëmbajtja verore dhe dimërore	260,040.22	/	Po 19.12.2017	Po 07.03.2019	E vlefshme

		2017/2018 R. Prizreni 2						
5	622-15- 316-521	Rehabilitimi dhe Asfalt i rrugëve ne Komuna e Prizrenit	319,364.84	19.87	Po 05.01.2016	Po 15.01.2018	E vlefshme	
6	/	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2014/2015 R. Prizreni 2	/	173.37	Është e shënuar me larte me numrin rendor 2	E vlefshme		
7	MI-14/051 /211	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2016/2017 R. Prizreni 2	705,199.57	173.37	Aneks kontrate Jo 25.08.2017	Po 07.03.2019	Nuk e ka prezantuar aneks kontratën 25.08.2018	
8	0.34	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Demjan	470,102.71	/	Po 29.08.2013 fillimi i Punimeve 02.08.2016	Po 12.09.2018	E vlefshme	
9	410/04-19176	aneks Asfaltimi i rrugës ne fshatin Demjan	46,676.20	/	Po 03.07.2018	Po 12.09.2019	E vlefshme	
10	632-16-081-511	Ndërtimi rrugës Bujar Roko – pjesa jugore e qytetit ne Gjakove	688,777.89	/	Po 02.06.2017	po	E vlefshme	
11	632-16-081-511	Aneksi Ndërtimi rrugës Bujar Roko – pjesa jugore e qytetit	64,917.87	/	Po 23.10.2017	Po 21.11.2017	E vlefshme	

		ne Gjakove					
12	62500.18. 044.521	Asfaltimi i rrugëve neper fshatrat Komuna e Malishevës	96,969.00	/	Po 18.06.2018	Po 10.06.2018	E vlefshme
12	62500.18. 044.521/5	aneks Asfaltimi i rrugëve neper fshatrat Komuna e Malishevës	9,276.00	/	Po 17.08.2018	Po 01.10.2018	E vlefshme
14	CWC/ICB/2013/ WL-Rec54-1	Rikonstruimi i rrugës Kukës - Shishtavec lot 2 NNTSH DRINI COMPANY shpk -40%	1,638,450.49	/	Po 28.04.2014	Po 11.09.2017	E vlefshme
			4,378,750.61		Shuma e kontratave te vlefshme		

Lidhur me pretendimin nr. 17 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company”i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Te Kapaciteti teknik dhe Profesional është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa është ofruar Bachelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit. Sqarim: duke u bazuar në neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale te Ligji i Prokurimit Publik të Republikës se Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/K-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L-092, vërejmë se “inxhinieri” i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton qe anëtari i stafit profesional i propozuar nga OE. (Besar Jetish Krasniqi) me profesion Baçelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit diplomuar me 24 shkurt 2010 nuk i plotëson kriterin III. 2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional e qe është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit te Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e tenderit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 18 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company”i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Se ka paraqitur kontratat e punëtore, ku të gjitha kontratat janë me noterizim të njëjtë . klauzola e noterizimit është në të gjitha të njëjtë si për nga forma ashtu për nga numër rendor i saj Nr. I LRP-se 3172/2019. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se OE me një numër (Nr. I LRP-se 3172/2019) i ka të vërtetuara të gjitha kontrata e punëtorëve , eksperti mendon se kjo është një shkelje dhe me këtë çështje mendoj se duhet të merren organet përgjegjëse sepse çdo kontrate është e veçanta dhe me numër identifikues të veçantë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 19 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company”i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Se i mungojnë deklarata për specifikime teknike dhe specifikacione teknike të detyrueshme , gjë e cila duhet të ishte në dosje Sipas nenit 28 i LPP-se Specifikimi teknik të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068. dhe Ligjin 05/ L-092. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se në dosjen e dorëzuar të këtij grupi të operatorëve ekonomik ju mungon deklarata për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 20 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company”i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, mungon identifikimi financiar sipas dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues sqaron se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim dokumenti Identifikimi Financiar nuk është e nevojshme të plotësohet në këtë fazë të tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Dëmet materiale:

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim, Dëmet material të llogaritura janë rreth 500€, për përgatitjen dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), sqaron se komisioni vlerësues nuk i ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, duke mos vepruar në pajtim, në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme sqaroje se disa nga pretendimet e palëve në ankesë janë të qëndrueshme dhe të aprovohen si të bazuara, (për arsye që u cekën tek përgjigja në pretendimet më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë. Autoritetin Kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të RI- VLERËSOHET dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës 11.10.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 16.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së, si dhe eksperti shqyrtues. U shqyrtuan shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE ankues znj. Morina deklaroj: Ne jemi pajtuar pjesërisht me mendimin e Eksperti Shqyrtues. Arsyeja e eliminimit nga ky tender është se jemi shpallur tenderues i pasuksesshëm për shkak të çmimit të lartë.

Pas datës **06.09.2019** ku Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" ka kthyer lenden në Ri-vlerësim, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës me datën **16.09.2019** ka shpallur Njoftimin B58 Njoftimin Mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, i cili e ka shpallur fitues Konkerciumin : JV: "Mirusha Company " Sh.P.K & " Lika Trade" Sh.P.K & " Infra- Plues" SH.P.K. Në atë ditë kemi dërguar kërkesën për qasje në dokumente të operatorit ekonomik e cila kërkesë na është pranuar dhe me datën **17.09.2019**, kemi pasur qasje në dokumente. Gjate qasjes në dokumente kemi kërkuar edhe e-mailit zyrtarë në mesë të autoriteti

kontraktues dhe operatorëve ekonomik kandidat për këtë projekt. Me datën **17.09.2019** kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim te tenderit Autoriteti Kontraktues: Komunës së Gjakovës. Me datën **19.09.2019**, Autoriteti Kontraktues i lartë përmendura ka sjell Vendim dhe e ka refuzuar kërkesën tone si të pabazuar duke e shpall përsëri fitues Konzorciumin : JV: "Mirusha Company " Sh.P.K& " Lika Trade" Sh.P.K &" Infra- Plus" SH.P.K. Me këtë Autoriteti Kontraktues na ka obliguar që të bëjmë Ankesën në OSHP, **20.09.2019**. Me datën **09.10.2019**, OSHP na ka sjell Vendimin e ekspertit Shqyrtues, ku në atë vendim ne si ne e-mailin e kthyer pajtohem i pjesërisht me mendimin e tij. Detajet se pse tenderit i Konzorciumit : JV: "Mirusha Company " Sh.P.K& " Lika Trade" Sh.P.K &" Infra- Plues" SH.P.K, duhet të shpallet i pasuksesshëm:

- Në vendimin e parë Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës të datës: **24.06.2019** Konzorciumin e lartë përmendur tashmë si fitues e ka shpallur tenderues të pasuksesshëm pasi që tenderi i tyre është refuzuar për këto arsyeje:

- * Certifikatën për Standardet EN 12352:2006 (për ndriçimin publik)
- * Në katalogun e ofruar për trupat ndriçues të kompanisë SUNBRIGHT SYSTEM BULGARIA Ltd, asnjë trup ndriçues nuk është 80W dhe 150W, gjithashtu asnjë karakteristik nuk është siç është kërkuar në FDT.
- * Certifikatat të atestimit vetëm për standardet EN 60598 - 1 (2015), EN 61000-3-2, EN 61347-2-13, EN 62031, EN 62471, siç është kërkuar në FDT.
- * Autorizimin për sinjalizim horizontal dhe vertikal e keni dorëzuar të kompania 3M respektivisht Helios.
- * Ju nuk e keni dorëzuar Certifikatën e ngjyrës sipas UNE- EN 1436: 2009, siç është kërkuar në FDT, dhe tash me vendimin e ri të Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës, këtë grup të Operatorëve Ekonomik ka shpallur të përgjegjshëm gjithë që edhe duke e shpallë fitues.
- Autoriteti Kontraktues haptas ka shprehur njëanshmëri ndaj Konzorciumit dhe ka qenë diskriminues ndaj operatorëve të tjerë pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm, duke ju kërkuar me email me datën **10.09.2019**, konzorciumit dokumentet të cilat kërkojnë për fituesin pas shpalljes së fituesit në faqen zyrtare. Dokumentet këto si: Vërtetimi Tatimor, Vërtetimi i Gjykatës dhe Vërtetimi i Tatimit në Prone ndërsa po në atë datë nga operatorët e tjerë ekonomik pjesëmarrës është kërkuar vazhdimi i validitetit të ofertës si dhe i sigurimit duke shprehur qartas diskriminim si dhe shpenzime të tjera për vazhdimin e sigurimit ndërsa fituesit veç se ishte shpallur në mënyrë jo transparente para se të bëhet njoftimi zyrtarë që është me datën **16.09.2019**.
- Gjate kontrollimit të dosjes së tyre të tenderit kemi vërejt në shumë parregullsi të tjera dhe në shumë mungesa të tjera të fituesit të tenderit:
- * Në platformën e E-prokurimit tek në fund është pjesa ku kërkohej edhe para masa në formatin excel, pjesë e cila mungon edhe tek formulari. Para masa në platformën elektronike është e obligueshme të jetë

në Excel, ajo mungon në dokumentacion e prezantuar nga konzorciumi në formularin e tenderit sipas e-prokurimit.

- Sigurimi i tenderit nuk është në emër të konzorciumit por vetëm në emër të dy operatorëve ekonomik "Mirusha Company" Sh.P.K & "Lika Trade" SH.P.K, ndërsa anëtarë i trete(3) i konzorciumit nuk është, si dhe tek sigurimi nuk figuron lideri i konzorciumit : "Mirusha Company" SH.P.K. por është "Lika Trade" SH.P.K.

- Sipas Nenit 28 i LPP - se - Specifikimet Teknike të Ligji i Nr.04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, partnerit të konzorciumit "Infra -Plus" Sh.P.K i mungon deklarata për specifikime teknike si dhe Aneksi I specifikacionet teknike të detyrueshme nuk janë të nënshkruara dhe të vëlosura nga të gjithë anëtarët e konzorciumit. Kjo shpije deri të mendimi se a pajtohet i gjitha anëtarët konzorciumi për kushtet dhe specifikacionet e këtij projekti. Neni 68 i LPP-se - Gjendja Ekonomike dhe Financiare e Operatorit Ligji i Nr.04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092,

1. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Operatori Ekonomik që të parashtrojë të dhënat për të treguar se ata a i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjë që operatori ekonomik "Infra - Plus" Sh.P.K i mungon Deklaratat tatimore vjetore për 3 vitet e fundit të kërkuara sipas FDT. Ku ceket qartë se të gjithë anëtarët e konzorciumit përqindjen e tyre për qarkullim vjetor. Sipas dosjes së tenderit për Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 Operatori Ekonomik "Lika Trade " SH.P.K, listën e pajisjeve të paraqitura nuk e ka sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Tek kjo vërejmë: Ekskavatorët me peshe minimale 13 t, ka paraqitur katër (4) ekskavator, të cilët nuk i ka me peshën e kërkuar, një (1) Ekskavator Tekeuchi, Tipi Tb180fr, viti i prodhimit 2009 e ka me peshe 8 ton, ndërsa sipas dokumentacionit të paraqitur dy të tjerë janë makineri Bager e jo ekskavator që i ka paraqit. Është me 03.05.2019. I mungon edhe një cilindër me peshe totale minimumi 4t deri 12 t. Ndërsa makineritë që i ka prezantuar ekspertit në mendimin e vet nuk janë as të cekura në dosje të tenderit dhe as të prezantuar si dëshmim doganor në dosjen e tyre, mund ta verifikoni edhe ju. Sipas dosjes së tenderit për Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 tek pjesa e autorizimeve për sinjalizim horizontal dhe vertikal nuk janë të paraqitura EN standardet sipas FDT dhe ka të prezantuar vetëm një pjesë të katalogut 3M gjithashtu ka të prezantuar vetë një pjesë të katalogut Traffic Yet dhe një certifikatë për printim të produkteve. Katalogu i prezantuar për sinjalizim të shenjave ka të bëjë vetëm me sinjalizim vertikal. Gjithashtu kompania Sun Bright nga Bullgaria nuk i ka të prezantuar katalogët për pjesë elektrike dhe trupat ndriçues por ka të prezantuar vetëm ca pjesë të katalogut si dhe i ka vetëm 3 EN Standarde e jo 12 siç i ka deklaruar. Ndërsa për

Operatorin Ekonomik SH. Drini Company Sh.P.K , është shpallur vendimi dhe nuk kemi pas te shtojmë detaje për të.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Halil Osmani deklaroj: Ne si AK qëndrojmë mbrapa vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Retkoceri deklaroj: Qëndroj mbrapa mendimit të dhënë ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Morina deklaroj: Kërkoj nga Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP që vendimin e Autoriteti Kontraktues: Komunës së Gjakovës, ta shpallë si të pavlefshëm dhe lenden e tenderit ta kthej në Ri-Vlerësim duke na shpallur neve fitues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së Halil Osmani deklaroj: Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të hedhë poshtë ankesën e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K , në bazë të Njoftimi mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues të datës 16.09.2019, kurse me vendimin e datës 24.06.2019, të Autoritetit Kontraktues është shpallur tenderues i pasuksesshme dhe tenderi i tyre është refuzuar.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit sqaron se duke u bazuara në fakte të prezantuara në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim në Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit përkatësisht seksioni II të FTD të ; Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2; Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkohet: Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.; Dëshmia e kërkuar

dokumentare Produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN (Produktet e ndriçimit publik dhe sinjalizimit janë të specifikuara në pozicionet e paramasës së projektit), - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara. Ndërsa gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar me rastin e dorëzimit të ofertës grupi i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar : Certifikatën për Standardin EN 12352:2006 , EN 62031 , EN 61347-1, EN 61347-2-13, EN 62031, EN 62471 (për ndriçimin publik në ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Referohuni në specifikimin teknik paramasa). në piken 3 dhe 4 ku kërkohet që: Raportet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (të dorëzohen me ofertë) – EN 60598-1 (2015), EN 12352:2006, EN 61000 – 3-2, EN 62031, EN 61347-1, EN 61347-2-13 EN 61547, EN 62031, EN 55015, EN 62471. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K në katalogun e ofruar për trupat ndriçues të kompanisë SUNBRIGHT SYSTEM BULGARIA Ltd, asnjë trup ndriçues nuk është 80W dhe 150W, gjithashtu asnjë karakteristik nuk është siç është kërkuar në FDT.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar si dëshmi katalogun për trupat ndriçues të kompanisë SUNBRIGHT SYSTEM BULGARIA Ltd ne të cilin nuk janë dhënë karakteristikat për trupat ndriçues 80W dhe 150W.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K ,nuk ka ofruar dëshmi për Certifikatën e ngjyrës sipas UNE- EN 1436: 2009, sipas kërkesës së dosjes së tenderit respektivisht në FDT.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është pjesërisht i bazuar, për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar si dëshmi CERTIFIKATËN numër : SKO5-ZSV -0220, të lëshuar nga një organ i pavarur i akredituar i certifikimit i Shteteve Anëtare të BE-së, që produkti Ngjyra e bardhë SIGNOCRYL për shenjat përputhet me kërkesat e standardeve të Bashkimit Evropian EN 1436 në lidhje me standardin EN të harmonizuar të Republikës së Sllovenisë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K ,nuk ka dorëzuar paramanën në formatin Exel.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është pjesërisht i bazuar, për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar paramasen sipas udhëzimeve të Manuelit për OE – Përgatitja dhe dorëzimi i Ofertës , E – Prokurimi. Plotësimi i çmimeve – Lista e Çmimeve Jo e standardizuar Nëse Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur Listën e Çmimeve Jo të Standardizuar, atëherë Lista e Çmimeve pjesë e Dosjes së Tenderit duhet të ngarkohet si dokument. Lista e Çmimeve mund të jetë në forma të ndryshme (Word, Excel, PDF).

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se autoriteti kontaktues Komuna e Gjakovës, ka bërë shkelje gjatë të ligjit, gjatë fazës së Ri- vlerësimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se: Kërkesa për vazhdimin e validitetit të tenderit nga OE në fjalë është bërë me datën 10.09.2019.

- Kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit si: Vërtetim i Administratës Tatimore, Vërtetim i Gjykatës dhe Vërtetimi i tatimit në pronë nga AK-ja me datën 10.09.2019
- Vazhdimi i validitetit të ofertës nga OE është bërë me datën 12.09.2019
- Data e nënshkrimit të raportit të vlerësimit nga Komisioni për vlerësim dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit është 13.09.2019.
- Publikimi i B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues është bërë me datë:13.09.2019 si dhe B42 Letrat standarde për tenderuesit e eliminuar, të pa suksesshëm dhe të suksesshëm. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se autoriteti kontraktues i ka udhëheq procedurat sipas ligjit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K ,nuk ka dorëzuar Sigurimin e tenderit në emër të konzorciumit por vetëm në emër të dy operatorëve ekonomik "LikaTrade" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K, ndërsa operatori tjetër "Infra - Plus" SH.P.K nuk është. Në Sigurimin e tenderit nuk është "Mirusha Company" SH.P.K e para pasi që është edhe lideri i konzorciumit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se sipas Ligjit Nr. 04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës

së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, Neni 57 – Sigurimi i tenderit paragrafi 1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender pra nuk përcaktohet se cili nga anëtarët e grupit duhet të bëjë sigurimin e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K. se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, partnerit të konzorciumit "Infra -Plus" Sh.P.K i mungon deklarata për specifikime teknike si dhe Aneksi i specifikacionet teknike të detyrueshme nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga të gjithë anëtarët e konzorciumit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se Deklarata e Specifikimeve teknike të detyrueshme është e nënshkruar nga anëtari i grupit Lika-Trade dt: 27.05.2019, kurse nga anëtarët e tjerë nuk është e nënshkruar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K. se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, partnerit të konzorciumit "Infra -Plus" Sh.P.K i mungon Deklaratat tatimore vjetore për 3 vitet e fundit të kërkuara sipas FDT.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se anëtarët e grupit “Mirusha Company” Sh.p.k& Lika-Trade” i kanë të bashkangjitura Deklaratat tatimore për tri vitet e fundit kurse Infra-Plus SH.P.K nuk e ka dorëzuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K. se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K. se diploma e inxhinierit z.Besmir Veselaj, inxhinier Gjeodet, diploma e tij është e noterizuar me datën 01.08.2016, gjë që është noterizim 3 vite me i vjetër.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se Dokumenti është valid sepse noterizimi i këtij dokumenti është bërë nga origjinali dhe në bazë të ligjit nr. 06/L-010, Për Noterinë, nuk është përcaktuar vlefshmëria e dokumentit të noterizuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, te kontrata e punës e inxhinierit te elektroteknikes z.Sami Shatri, është nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019 e cila nuk është kontrate pune deri ne fund te projektit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se kontrata e inxhinierit te elektroteknikes z.Sami Shatri, është valide sepse me rastin e dorëzimit te ofertave numri i ditëve të përfundimit te kontratës se inxhinierit te Elektroteknikes është me i madhe se sa numri i ditëve te planit dinamik (179 ditë) për kryerjen e punimeve i dorëzuar me rastin e dorëzimit te ofertës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, te Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 Operatori Ekonomik "Lika-Trade " SH.P.K, listën e pajisjeve te paraqitur nuk e ka sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Ekskavatorët me peshe minimale 13 t, ka paraqitur katër (4) ekskavator, te cilët nuk i ka me peshën e kërkuar Është me minus një kamion sepse njeri kamion me targat: 03-921-DB i ka skaduar regjistrimi me dt:03.05.2019.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se këto mjete ne baze te listave te pajisjeve të dorëzuara nga anëtarët e grupit i plotëson kërkesën sipas listës se pajisjeve pika 1 Ekskavatorët me peshe totale minimumi 13 t dhe atë ne baze të Kontratës mbi shit blerjen e makinerive te renda dt: 08.08.2012 e mes te Construcsioni Gienerali Italia L.L.C. dhe Mirusha Company.

- Eskoator PC 210 viti 2003 Pesha 16300kg
- Eskovator KOMATSU tipi PC 160 LC -7K viti 2003 Pesha 16300kg
- EskavatorO&K tipi RH6-22 1999 pesha 22000kg

Në bazë të faturës 13/15 dt 01.12.2015

- Eskavator PC340 viti 2000 Pesha 24600kg

Pesha e tyre është konstatuar në bazë te Dudit Doganor apo te katalogut te tyre ne faqe te internetit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Sh.p.k; & LikaTrade" Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, ku të njëjtit janë me minus një kamion sepse njeri kamion me targat: 03-921-DB i ka skaduar regjistrimi me dt: 03.05.2019, njëherit numrin i kamionëve te cilët janë ne listat e pajisjeve qe i kanë ne posedim te dy

anëtarët e te grupit “Mirusha Company” Sh.p.k; dhe "LikaTrade " SH.P.K, është njëmbëdhjetë. Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit duke u bazuar në dëshmitë konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, tek Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 Operatori Ekonomik "LikaTrade " SH.P.K, listën e pajisjeve te paraqitur nuk e ka sipas kërkesës se dosjes se tenderit te lista e pajisje nr. 5 I mungon e një cilindër me peshe totale minimumi 4t deri 12 t.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se këto mjete ne baze te listave te pajisjeve te dorëzuara nga anëtarët e grupit i plotësojnë kërkesën sipas listës se pajisjeve te kërkuar te pika 5 . Cilindër apo rula ngjeshës me peshe totale minimum 4t deri ne 12 t dhe atë.

- Marka HAMM HW90B/12 nr. serik: 2333637 viti 1992 Referenca doganore R 21557 “LikaTrade”
- Cilindër i përdorur marka : HAMM tipi : DV6K nr. serik 45808 viti 2001 pesha : 7500 kg Referenca doganore R 21549 dt. 18.07.2013 “LikaTrade”
- Makina ngjeshës Rulet tipi HD 75 K, pesha: 9790 kg, viti 2004 nr serik H1520665 numri i faturës 01/2019 dt. 21/02/2019“Mirusha Company” Sh.p.k;.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë “Mirusha Company” Sh.p.k; & LikaTrade” Sh.p.k. & Infra-Plus SH.P.K, sipas dosjes se tenderit për Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1&9.2 tek pjesa e autorizimeve për sinjalizim horizontal dhe vertikal nuk janë te paraqitura EN standardet sipas FDT, dhe ka te prezantuar vetëm një pjese te katalogut 3M, gjithashtu ka te prezantuar vetëm një pjese te katalogut Trafic Yet, dhe një certifikate për printim te produkteve.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se gjate shqyrtimit te dokumentacionit te ofruar me rastin e dorëzimit te ofertës grupi i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar Certifikata UNE-EN 1436:2009 +A1 2009- Sinnjalizimi Horizontal si dhe Diamond Grade EN 12899 Min. 27 luminance KR 580-420-120 Cd/Lux/m2 1-7 vite 80% 8-11 vite 70%, katalogët e dorëzuar nuk i përshkruajnë te gjitha elementet e sinjalizimit siç janë kërkuar.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit sqaron se të gjitha pretendimet e OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues për OE SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm e janë të shqyrtuara me pare me Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 400-419 të datës 13.08.2019, me dhe për të cilat është marre vendim nga OSHP-ja 400-419 të datës 06.09.2019.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se operatori ekonomik SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm. Ne mbështetjen e tij bankare siç është kërkuar në dosjen e tenderit nuk e ka të sakte emërtimin e projektit si në dosjen “ Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores- Transiti i ri (në gjuhën angleze: Re Tender Construction of Circular - New tranzit) por e ka me titull të projektit të mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Transiti i Ri (në gjuhën angleze si e ka në Mbështetje Bankare: Construction of Qarkores – Transiti i ri) gjë e cila po bije në kundërshtim me dosjen e tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues .

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit sepse Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të drejtë sepse Operatori ekonomik në mbështetjen bankare të dorëzua i ka të shënuara të dy numrat atë të prokurimit dhe atë të numrit të brendshëm sipas Dosjes së shpallur kurse emri mendoj se është një shkelje e vogël e cila nuk duhet të merret si shkelje. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se operatori ekonomik SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, tek pjesa e kontratave për punë të ngjashme kemi vërejtur se kontrata e OE: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015-2016, kjo kontratë nuk figuron si kontrata të tjera por që vërejmë se Kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 është përsëritur dy herë në mënyrën e njëjtë kurse kontrata Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale së Republikës së Kosovës 2015-2016, nuk figuron në dosjen e tij për punë të ngjashme dhe as nuk është pranimit teknik, veçmas një referencë e lëshuar në 03.11.2017, por që kjo kontratë nuk duhet të pranohet as si kontrata e valide e as si referencë pasi që është e vitit 2014/2015, dhe që në dosje të tenderit kontratat për punë të ngjashme duhet me qenë të tri {3} viteve të fundit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se operatori ekonomik në fjalë të njëjtën kontratë (Mirëmbajtja

verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015-2016) në regjistrin e kontratave e ka përsëritur dy here kurse në llogari është llogaritur vetëm një here.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se operatori ekonomik SH." Drini Company" i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, tek lista e kontratave gjithashtu ka paraqitur kontratën Rikonstruktimi i Rrugës Kukës – Shishtavec, Lot 2 me vlerë 4,126,156.78€, në të cilin projekt Sh. Drini Company SH.P.K nuk është lideri por vetëm si partner i dytë me 40% i tij i cili i bije të ketë vlerën 1,600,000.00€. Nga kjo rezultojnë se Operatori Ekonomik nuk e përmbush kërkesën sipas dosjes së tenderit ku kërkohen që Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3{tri} vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratën. Në një vlerë se jo më pak se 5.000.000.00€ gjë që Operatori Ekonomik Sh. Drini Company nuk e përmbush këtë kriter dhe vlera e kontratave për punë të ngjashme mbërrin: 4,615,203.3€.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik sqaron në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në baze të kontratës dhe formularit të vlerësimit Nga : Fondi Shqiptar i Zhvillimit tek % e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punimeve të kryera nga secili anëtarë është se NNTTSH "DRINI COMPANY" SHPK -40% të punimeve i ka kryer dhe shuma e punimeve të kryera sipas kësaj kontrate është $= 543,105,378.25 \text{ lek} \times 0.4 = 217,242,151.30 / 132.59 = 1,638,450.49 \text{ euro}$. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, kontratat e lartpërmendura janë të cekura në ekspertizë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se operatori ekonomik SH." Drini Company" i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, tek Kapaciteti teknik dhe Profesional është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa është ofruar Bachelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit. Sqarim: duke u bazuar në nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/K-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L-092, vërejmë se "inxhinieri" i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se anëtari i stafit profesional i propozuar nga OE. (z.Besar Jetish Krasniqi) me profesion Baçelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit diplomuar me 24 shkurt 2010 .nuk i plotëson kriterin III. 2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional e që është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë

mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit të Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se operatori ekonomik SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, ka paraqitur kontratat e punëtorëve, ku të gjitha kontratat janë me noterizim të njëjtë . klauzola e noterizimit është në të gjitha e njëjtë si për nga forma ashtu për nga numër rendor i saj Nr. I LRP-se 3172/2019.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se OE në fjalë me një numër (Nr. I LRP-se 3172/2019) i ka të vërtetuara të gjitha kontratat e punëtorëve. Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit vlerëson se kjo është një shkelje dhe me këtë çështje duhet të merren organet përgjegjëse sepse çdo kontratë është e veçantë dhe me numër identifikues të veçantë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se operatori ekonomik SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, i mungojnë deklarata për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme , gjë e cila duhet të ishte në dosje Sipas nenit 28 i LPP-se Specifikimi teknik të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092. Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se në dosjen e dorëzuar të këtij grupi të operatorëve ekonomik ju mungon deklarata për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se operatori ekonomik SH.” Drini Company” i cili është shpallur si tenderues i përgjegjshëm, i mungon identifikimi financiar sipas dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar, për faktin se Identifikimi Financiar nuk është e nevojshme të plotësohet në këtë fazë të tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit të jashtëm teknik të prokurimit, vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikojë dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet dhe referencat (e grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për

kontratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për kontratë a i përmbush të gjitha kërkesat ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues, në dosjes e tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi, Paneli Shqyrtues



Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjakovës

1x1 OE- “PE-VLA-KU” SH.P.K. – Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.